



KUVENDI I KOMUNËS KLINË

Shërbimi për punë të Kuvendit

01 Nr. 06-699/15

Klinë me 30. 01. 2015

EKSRAKT-PROCESVERBAL

Nga mbledhja e **I-re e Kuvendit të Komunës** për vitin 2015 e mbajtur me datën **30. 01. 2015** (e premte) në sallën e Kuvendit të Komunës me fillim në orën **10:00**.

R e n d i i d i t ë s :

1. Arsyetimi i mungesave,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar,
3. Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane në territorin e Komunës e Komunës së Klinës,
4. Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për vënie në diskutim publik të Projekt-Rregullores për Lejet Mjedisore Komunale,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së Prokurimit për vitin 2015,
6. Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së KKSb-se për vitin 2015,
7. Interpelancë e drejtoreshës për Kulturë, Rini dhe Sport,
8. Të ndryshme.

Prezent në mbledhje ishin: Kryesuesi i Kuvendit dr. Haxhi Ibishi dhe anëtarët e tjerë të Kuvendit.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje ishin: Kryetari i Komunës z. Sokol Bashota, Nënkryetari i Komunës z. Enver Berisha, përfaqësues të OSBE-se, të KFOR-it, të zyrës Ligjore të Komunës, të Policisë së Kosovës, Dardan Bashota-udhëheqës i sektorit për mbrojtjen e mjedisit, Abaz Foniqi-zyra e prokurimit, zyrtarja për informim znj. Samije Gjergaj, përfaqësues të OJQ-ve, mediet dhe drejtorët e drejtorive Komunale.

Mbledhjen e hapi z. Haxhi Ibishi – Kryesuesi i Kuvendit i cili pasi i përshëndeti të gjithë të pranishmit i informoi ata me Vendimin e Komisionit Qendror Zgjedhor që në vend të këshilltarit të deritashëm të Kuvendit të Komunës nga radhët e AAK-se z. Agron Bacaj i cili ka dhënë dorëheqje nga kjo pozitë është emëruar z. Lorencë Marleku, Unë e ftoi z. Lorenc Marleku që të jep betimin.

Lorenc Marleku dha betimin si këshilltar i ri.

Dr. Haxhi Ibishi i lexoi pikat e rendit të ditës të parapara për shqyrtim në këtë mbledhje dhe shtoi së në pikën e rendit të ditës “Te ndryshme” na duhet miratimi i gabimeve teknike të Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoha Komunale e kërkuar kjo nga Komisioni Ndërmintor, dhe miratimin e rritjes së buxhetit të Komunës nga të hyrat vetanake sipas kërkesës së drejtorisë për Ekonomi dhe Financa dhe hapi debat rreth rendit të ditës.

Arben Limanaj tha së në grupi Kuvendar i LDK-se kërkojmë që në pikën e rendit të ndryshme që mund të jetë për mbledhjen e ardhshme të Kuvendi kërkojmë një raport nga drejtorja e Shërbimeve Publike për formën e shpërndarjes së druve që konfiskohen nga drejtorja e Pyjeve dhe për nivelin e pastrimit të rrugëve gjatë sezonit dimëror.

Fadil Gashi pyeti së a ka pasur shërbimi i Kuvendit zarfa edhe me të mëdha së këto? dhe shtoi së kjo është neglizhencë e punës dhe pa përgjegjësi.

Qamile Çitaku propozoi që për mbledhjen e radhës të ftohet policia e Kosovës të na raportoi për gjendjen e sigurisë në Komunë.

Rexhë Berisha - Komandant i stacionit Policor në Klinë tha së në përherë i raportojmë kryetarit të Komunës për gjendjen e sigurisë.

Rendi i ditës u miratua unanimisht nga anëtarët e Kuvendit.

Pika e I-re: Arsyetimi i mungesave

Dr. Haxhi Ibishi tha së unë nuk kamë ndonjë konfirmim nga ana e atyre që sot mungojnë.

Pika e II-te: Shqyrtimi dhe miratimi i procesit të mbledhjes së kaluar

Procesi i mbledhjes së kaluar u miratua unanimisht.

Pika e III-te: Shqyrtimi dhe miratimi i projekt-Rregullores për organizimin dhe bashkëpunimin e Komunës më fshatrat, vendbanimet dhe Lagjet Urbane në territorin e Komunës së Klinës

Ali Shala- Zyra Ligjore e Komunës tha së për këtë Projekt-Rregullore janë kryer të gjitha procedurat dhe vetëm ka mbetur sqarimi financiar nga drejtorja e Financave , vërejtjet kryesore janë bërë në mbledhjen e KPF-se dhe në debatin me Publikun që tek neni 7 pika 2 që fjala “ duhet” të zëvendësohet me fjalën ‘mund’ s i përbërja e këshillave lokale (duhet) mund të reflektoi përbërjen etnike dhe gjinore dhe së përfaqësimi gjinor duhet të jetë 30%. Vlerat e kompensimit duhet të behën nga ana e Kuvendit të Komunës me Vendim të veçantë. Kjo është një nder Rregulloret më të rëndësishme të Komunës, qëllimi i saj është të formohen këto këshilla ndihmëse të Komunës, këto trupa janë profesionale dhe jo politike.

Prend Buzhala pyeti së kush e mbikëqyr punën e këtyre këshillave dhe duhet ta dimë a kompensohen a jo?

Fadil Gashi: tha së tek neni 18 - kompensimi i kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave lokale, ne i kemi 54 fshatra= 54 këshilla lokale nga 7 anëtar = 378 anëtar nga 50 euro në muaj po del një shumë bukur e lartë pa kryetar të këshillave dhe së edhe ato Komuna që e kanë miratua këtë rregullore nuk po mund ta implementojnë.

Skender Merturi tha së është mirë të merremi vesh për mënyrën e kompensimit dhe numrin e anëtarëve të këshillave e pastaj ta miratojmë.

Ndue Shabanaj tha së për këtë projekt-Rregullore kemi debatuar disa herë edhe ne debat me Publikun dhe në KPF është kërkuar që në mbledhjen e Kuvendit drejtoria për Ekonomi dhe Financa të na sjell një parallogari së sa do të na kushtoi kompensimi për zbatimin e saj, në nenin 4 paragrafi 3 thuhet së një këshill lokal mund të përfshijë disa fshatra, lagje dhe vendbanime dhe kjo mendoj së është bazë e mirë për zvogëlimin e këtyre këshillave. Tek neni 7 unë mendoj së është vështirë të përfillet struktura gjinore.

Tunë Dedaj tha së është propozimi që fillimisht të kompensohen vetëm kryetarët e këshillave lokale ndërsa anëtarët të mos paguhen, sa do të jetë kjo efektive?

Halil Desku tha së neni 4 pika 3 e shtinë në funksion këtë Rregullore sepse kemi mundësi të grupimit psh Ujmiri ti përfshij disa fshatra për rreth e kështu me radhë, mendoj së është mirë që ekzekutivi te formoi një komision ekspertesh që ta bëjnë vlerësimin për këtë.

Prend Buzhala propozoi që të formohen këshillat në bazë të qendrave të votimit dmth kjo të merret si mostër.

Sokol Bashota-kryetar i Komunës tha së Komuna jonë i ka 54 fshatra nga 7 anëtar e nëse paguhen vetëm nga 20 euro po del diku rreth 64 mijë euro e kjo është një shumë bukur e madhe, Në Komunat e tjera këto këshilla kompensohen vetëm kur ftohen nga Komuna, sepse asnjë Komunë ku është miratuar kjo Rregullore nuk kanë mundur me e zbatua dhe për këtë drejtoria për Ekonomi dhe Financa në bashkëpunim me zyrën Ligjore duhet ta shikojnë mundësin së si do të veprojmë.

Qamile Çitaku tha së medoemos duhet të respektohet përfaqësimi gjinor dhe për këtë kërkoi nga kryesuesi i Kuvendit 15 minuta pushim për tu konsultuar me grupin e grave të Kuvendit- pas kësaj pauze Qamile Çitaku tha së grupi i grave Kuvendare ka paraparë që medoemos duhet të respektohet neni 7 me përfaqësim gjinor prej 30%.

Ramush Agushi tha së askush nuk është kundër përfaqësimit gjinor prej 30%.

Ndue Shabanaj tha së në fshatra është vështirë të angazhohen femrat dhe do ishte mirë që përfaqësimin gjinor ta siguroi grupi i grave Kuvendare.

Sokol Bashota tha së ne e dimë mentalitetin e shumë zonave rurale andaj pajtohem që Ju grupi i grave Kuvendare ta merrni obligimin për sigurimin e kësaj përqindjeje.

Marije Selmanaj tha së unë mendoj së në neni 7 pika 2 fjala “duhet” të zëvendësohet me fjalën mund sepse ne nuk mund ta detyrojmë askënd të merre pjesë në këto këshilla lokale.

Dr haxhi Ibishi e hodhi këtë projekt-Rregullore në votim dhe u MIRATUA unanimitisht nga anëtarët e Kuvendit.

Ramiz Rrusta tha së unë dua të Ju njoftoi me Vendimin e Ministrisë së Financave lidhur me kompensimin e anëtarëve të komiteteve – komisioneve ku thuhet së nëse një shërbyes civil merr pjesë në ndonjë komitet- komision ai nuk ka të drejtë kompensimi donë me thanë së me këtë Vendim anashkalohen të gjithë anëtarët e komiteteve- komisioneve që marrin pagë nga buxheti i Kosovës.

Pika e IV-te: Shqyrtimi dhe miratimi i propozim-Vendimit për vënie në diskutim publik të projekt-Rregullores për Lejet Mjedisore Komunale

Baki Gashi- drejtor i drejtorisë për urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit tha së në bazë të Ligjit jemi të obliguar që ta kemi një Rregullore të tillë që është e një rëndësie të madhe, kjo iniciativë është shqyrtuar në mbledhjen e KPF-se , ai kërkoi nga këshilltarët miratimin për vënie në diskutim publik.

Dr. Haxhi Ibishi e hodhi në votim këtë propozim-Vendim dhe u MIRATUA unanimitisht nga këshilltarët e Kuvendit.

Pika e V-te: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të prokurimit për vitin 2015

Abaz Foniqi tha së duke u bazuar në LPP nr 04/L -042 neni 8 është përgatitur planifikimi final i prokurimit për vitin 2015 si dhe duke u bazuar në buxhetin e miratuar nga Kuvendi i Komunës dhe kërkesave nga njësitë shpenzuese të Komunës e kemi bërë këtë planifikim i cili ne vete përmban edhe kërkesa që nuk janë të planifikuara në buxhet por i kemi lenë ashtu siç kanë kërkuar drejtoritë duke shpresuar së ndonjë projekt mund të financohet nga ndonjë donator.

Çmimet e furnizimeve janë çmime të dhëna nga KRPP që kanë lëshuar një urdhëresë duke bërë kontrollim të tregut sidomos për kategori të furnizimeve me material shpenzues për zyre , atë higjenik dhe gjerat ushqimore.

Avni Gashi – tek blerja e ushqimeve do ishte mirë të blihem prodhime vendore dhe për asfaltimin e rrugëve në qytet do të ishte mirë të dihet së cilat janë ato rrugë.

Sokol Bashota tha së për qendrën e qytetit kemi paraparë që të ndërrohen gypat e kanalizimeve deri tek sheshi “Nëna Terezë” dhe e gjithë qendra e qytetit do të rregullohet me material guror.

Plani i prokurimit për vitin 2015 u MIRATUA unanimitisht

Dr. Haxhi Ibishi tha së nga drejtorja e financave kemi një kërkesë.

Ramiz Rrusta tha së kemi një rritje të buxhetit Komunal nga të hyrat vetanake në shumë prej 76.415.43 mijë euro andaj në bazë të Ligjit për Financat e pushtetit Lokal kërkoi nga Kuvendi miratimin e kësaj rritjeje buxhetore.

Kërkesa e rritjes së buxhetit nga të hyrat vetanake miratohet unanimisht nga Kuvendi.

Pika e VI- te: Shqyrtimi dhe miratimi i planit të punës së KKSB-se për vitin 2015

Enver Berisha-nënkryetar i Komunës tha së ju planin e punës së Këshillit Komunal për Sigurinë e Bashkësive e keni marrë së bashku me ftesat, ai e njoftoi Kuvendin me planin e punësi hartuar prej disa pikave: siguria në shkollë, ndriçimi i rrugëve në afërsi të shkollave, vendosja e shkallëve emergjente, ndërtimi i trotuareve në relacionet Kinë-Deiq, Klinë-Videjë dhe Klinë Krushevë e Vogël, mbyllja e lokaleve në afërsi të shkollave të cilët nuk janë në përputhje me Ligjet në fuqi, fushatë vetëdijësuese për parandalimin e dukurive negative kundër drogës, duhanit etj, sigurimi i vend parkimeve për autobusët që bartin nxënësit pastaj zvogëlimi i rreziqeve nga qenët endacak e shumë të tjera.

Rasim Millaku tha së sa i përket qenve endacak kemi një rrezikshmëri të lartë, vetëm në lokalitetet e bashkësisë lokale të Ujmirit ka shumë qenë e që në kohën e dimrit janë edhe me të rrezikshëm, prindërit i përcjellin fëmijët e tyre në shkollë sepse nga frika fëmijët nuk shkojnë në shkollë. Ne duhet urgjentisht të gjejmë një zgjidhje për këtë problem.

Tunë Dedaj tha së është bërë një punë e mirë në vendosjen e kamerave e shumë punë të tjera ndërsa sa i përket rrezikut nga qenët endacak do ishte mirë që të shfuqizohet ai Ligj që ndalon vrasjen e tyre në mënyrë që të largojmë rrezikun, mendoi së vrasja e qenve nuk është krim.

Ndue Shabanaj tha së i bashkohem shqetësimit për gjetjen e një mënyre për eliminimin e qenve endacak, unë mendoi së për këtë problem duhet të gjendet një zgjidhje, ndërsa projekti për ndërtimin e trotuarit Klinë-Krushevë e Vogël është miratuar në vitin 2004, dhe ai trotuar është ndërtuar deri tek lagja e Colve dhe me tej nuk ka shkuar.

Enver Berisha tha së edhe ky projekt për ndërtim të trotuarit Klinë-Krushevë e Vogël do i bashkëngjitet dy projekteve që i përmenda me parë, e sa i përket qenve endacak tha së kjo është një temë që po trajtohet edhe në nivel Qendror dhe shpresoj së do të gjendet një zgjidhje.

Plani i punës së Këshillit Komunal për sigurinë e Bashkësive për vitin 2015 u miratua unanimisht.

Pika e VII-te: Interpelanca e drejtoreshës së drejtorisë së kulturës

Prend Buzhala tha së në Komitetin për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport disa herë kemi diskutuar për këto probleme dhe përmes grupit Kuvendar tre plus kemi kërkuar këtë interpelancë.

Kristine Lazri – drejtoreshë e drejtorisë së Kulturës tha së unë do të mundohem të jap sqarime për të gjitha pyetjet që na janë drejtuar përmes kësaj interpelance: pyetja e parë: Pse nuk ka staf Jehona e Dukagjinit? **Jehona e Dukagjinit ka staf**, e dyta: A ka dokumentacion të rregullte së është pranuar objekti? **Nuk është bërë akoma pranimi teknik**, e treta: pse nuk kalon stafi në shtëpinë e kulturës? **Stafi në shtëpinë e Kulturës do të kaloj ne muajin mars.**

E katërta: Biblioteka ka pas degë të tjera neper fshatra çka është bërë me ato prona dhe kush i ka uzurpuar? **Unë e di që biblioteka ka nëpër shkolla ndërsa ato objekte janë nen menaxhimin e AKP-se**, e pesta: është blerë gardëroba për kulturë, ku gjendet tash ajo gardërobë dhe a përdoret për veprimtari kulturore?

Gardëroba është në Komunë dhe përdoret për veprimtari kulturore. E gjashta: Pse nuk financohet trashëgimia kulturore? **Trashëgimia kulturore financohet dhe vetëm sivjet janë ndarë 20 mijë euro.** E shtata: Pse nuk financohen poligonet sportive?

Poligonet sportive financohen nga Komuna rregullisht ndërsa palestra sportive është duke u ndërtuar nga Ministria e Kulturës. E teta: Në drejtorinë e kulturës mungojnë dy zyrtar, zyrtari për rini dhe zyrtari për muzikë Pse? **Shumë shpejtë do të hapët konkursi për këta dy punëtor.** E nënta: pse ne këtë drejtori paguhet një punëtor që nuk është punëtor i saj? **Unë nuk e di së ka një rast të tillë.**

Tunë Dedaj: Unë e kuptoi drejtoreshën së nuk ka mundur të bej ndryshime por mendoi së më shumë duhet të merreni me rininë që ata të angazhohen në aktivitetet sportive e aktivitete të tjera.

Prend Buzhala tha së për shtëpinë e kulturës unë e kamë parë së është prerë shiriti e tash po e kuptoi së ajo paska qenë fushatë zgjedhore.

Sokol Bashota tha së për shtëpinë e kulturës kemi një punë shtesë dhe një buxhet shtesë dhe shumë shpejt ato punë do të kryhen, ky do të jetë një objekt i denjë dhe do të i plotësoi të gjitha kushtet. Festivali “ I këndojmë Lirisë” për një kohë është vetë financuar, Komuna për këtë i ka ndarë 15 mijë euro. Klubi i futbollit “Dukagjini” përkundër që ka qenë nën piken zerro kemi bërë përpjekje që ta ngrisim aq sa kemi mundur, poligonet sportive kemi ber përpjekje të i rregullojmë nëpër oborre të shkollave dhe nëpër fshatra, së shpejti do të bëjmë rregullimin e studionit të qytetit dhe do të këtë edhe objekte të tjera ndihmëse .

Pika e VIII-te: Të ndryshme

Dr. Haxhi Ibishi tha së Rregullorja për taksa, tarifa dhe gjoba Komunale na është kthyer nga Komisioni Ndërmintor për përmirësimin e disa gabimeve teknike në tekstin e kësaj Rregulloreje andaj nevojitet miratimi nga ana e Kuvendit.

Korrigjimet e këtyre gabimeve në këtë Rregullore u miratuan unanimisht nga anëtarët e Kuvendit

Me kaq mbledhja e Kuvendit të Komunës përfundoi punën në orën 14:00.

Procesmbajtësi,
Beqir Gashi



Kryesuesi i Kuvendit,
Dr. Haxhi Ibishi